



BASHKIA VLORË – DREJTORIA E URBANISTIKËS

# RIKONSTRUKSION I RRUGËS “MENO GJOLEKA DHE “HARUN PANAJA”.

**RELACION PËRSHKRIMI**

## RELACION PËRSHKRIMI

### 1. Rruga “Mëno Gjoleka” dhe “Harun Panaja”.

Rruga “Mëno Gjoleka” dhe “Harun Panaja” ndodhet përgjatë Lungomares duke lidhur një pjesë të rëndësishme të qytetit. Rruga është e gjatë rreth 315m dhe rrethohet me ndërtesa të larta dhe shtëpi private.



Për realizimin e këtij projekti janë kryer studime ne terren te gjendjes faktike te rruges ne te gjithe gjatesine e saj. Mungesa e investimeve ne kete segment ka çuar ne një gjendje ku nevojiten ndërhyrje te menjëhershme. Këto ndërhyrje duhet të jenë në të gjithë sipërfaqen e segmentit rrugor.

Ndërhyrja e përgjithshme do te konsistojë ne te gjithë gjatësinë e rrugës si dhe rindërtimi i pjesëshëm i nje kanali kullues anësor.

Gjendja ekzistuese e trupit të rrugës.





Shtresat që do të përdoren në të gjithë rrjetin rrugor janë si me poshtë

- shtresë stabilizanti 15 cm
- shtresë binderi 6 cm
- shtresë asfalto betoni 4 cm.

Projekti parashikon riasfaltimin e plotë të rrugës dhe riparimi i dëmeve të lokalizuara.

Rruga ekzistuese përpara fillimit të punimeve do të rafshohet me eskavator dhe mbasi të realizohet një profil i një trajtshëm do të shtrohet mbi rrugë një tapet stabilizanti 15 cm në të gjithë gjatësinë e rrugës. Përpara fillimit të shtresave asfaltike do të realizohet kuneta anësore e hapur në pjesën ku mungon. Mbi tapetin e stabilizantit do të plotësohet më tej shtresa e binderit 6cm dhe e asfaltobetonit 4 cm. Mbas përfundimit të shtresave puna do të vijojë më tej me vijëzimin gjatësor të rrugës. Rruga ka gjatësinë rreth 315 ml.

PUNOI: Ark. Erisa Muka  
Ark.Orges Deraj  
Urb.Evangjelica Rapaj  
Ing.Darjan Hudhra

